


TIRANA E DEKADËS SË ARDHSHME: KRYEQYTETI I MUNDËSIVE PËR TË RINJTË, ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE BARAZISË GJINORE

Në dekadën e ardhshme, Tirana ka në plan të transformohet në një kryeqytet më të aksesueshëm dhe me larmishmëri mundësish për të rinjtë. Për të arritur këtë, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë politikash dhe iniciativash që synojnë përmirësimin e kushteve për të rinjtë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto masa përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës, mbështetje për sipërmarrësit e rinj dhe avancimin e barazisë gjinore.

Bashkia e Tiranës është angazhuar për të bërë qytetin më të jetueshëm dhe të aksesueshëm për të rinjtë përmes përmirësimit të infrastrukturës publike dhe ndërtimit të hapësirave rinore.

Në vitin 2023, Tirana inaguroi Piramidën si një hapësirë të re inovative dhe përfundoi restaurimin e rezidencave studentore. Gjithashtu krijimi i Agjencisë së Industrisë Kreative i ka dhënë një hov të ri jetës kulturore të qytetit. Agjencia ka për qëllim zhvillimin e industrisë krijuese, artit dhe teknologjisë në Tiranë si dhe synon rivitalizimin e kinemave të qytetit dhe ngritjen e zyrës së filmit, duke ofruar mundësi për të rinjtë që të angazhohen në sektorë të ndryshëm krijues.



Karta e Studentit është një tjetër mjet që ofron avantazhe dhe tarifa të reduktuara për studentët në institucione publike dhe private. Ajo ofron lehtësira në transport dhe zbritje nga tarifatat standarte, duke lehtësuar kostot e përditshme për studentët. Po ashtu, me Vendim të Këshillit Bashkiak në 2022-shin, Bashkia Tiranë vendosi subvencionimin me 50% të tarifës për të gjithë studentët që jetojnë në konvikte, duke marrë parasysh që në të ardhmen do të jenë kontribues në qytetin e Tiranës.

Jo vetëm kaq, por Tirana e dekadës së ardhshme ka edhe një fokus të veçantë në politikat e saj edhe për një sistem të përmirësuar të shërbimeve të punësimit. Nga Prilli 2021, një sistem i ri i Zyrës së Punës ofron informacione më të detajuara për punëkërkuarit dhe përdor kriteret e profesionit aktual, profesionit të dëshiruar dhe preferencën e distancës për të lidhur kërkesën me ofertën për punë. Drejtoria e Nxitjes së Punësimit gjithashtu ka financuar çdo vit 20 ide biznesi nga gratë dhe 20 sipërmarrje të rinjve, si dhe ka ofruar kurse profesionale pa pagesë në Qendrat e Formimit Profesional. Ekosistemi i start-upeve në Tiranë pritet gjithashtu të vijojë në rritje, ku parashikohet të nxitet nga faktorë të tillë si aksesimi në financim, politikat mbështetëse të qeverisë dhe prania e hapësirave të bashkëpunimit.

Fokus qëndror në politikat zhvillimore merr edhe mbrojtja e mjedisit, ulja e emetimeve të karbonit dhe kthimi i Tiranës në një qytet më të gjelbër. Për këtë të fundit është miratuar edhe plani i veprimit për “ Qytetin e Gjelbër”. Planin, i miratuar në qershor 2018, përfshin investime në lëvizshmërinë e qëndrueshme, efikasitetin energjetik, hapësirat e gjelbra dhe biodiversitetin, menaxhimin e burimeve dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike. Ai synon të ndihmojë në arritjen e objektivit të reduktimit të gazrave serrë me 11.5% deri në vitin 2030.

Edhe nxitja e barazisë gjinore dhe mbështetja për zhvillimin profesional të grave është një tjetër kapitull i rëndësishëm i Tiranës në dhjetë vitet e ardhshme. Në këtë drejtim Bashkia synon të ngrejë një Komision të Barazisë Gjinore. Ky komision pritet të rrisë përgjegjshmërinë dhe transparencën në përmbushjen e angazhimeve për barazinë gjinore dhe për të investuar në ndërtimin pozitiv të ndarjeve gjinore. Fokus të veçantë do të ketë edhe zbatimin e detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjithshëm gjinor për të mbështetur barazinë gjinore në nivel vendor.

Me këto politika dhe iniciativa, Tirana synon të transformohet në një qytet që ofron mundësi të pafundme për të rinjtë dhe që e bën qytetin një vend më të mirë për të jetuar dhe për të kontribuar në të ardhmen e tij.